



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:101265
Datë: 31.01.2025
Numri i dokumentit: 06783778

Rev.nr.595/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Mr.sc.Muhamet Rexha dhe Millena Gjeriq, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses E. V. nga P., të cilën me autorizime përfaqëson avokat Ismet Musliu nga P., kundër të paditurit Aeroporti Ndërkombëtar “L. K.” sh.a., me seli në fshatin V., komuna e L., të cilën me autorizim e përfaqëson avokat Sh. S. nga F. K., për shkak të kompensimit të ardhurave personale, duke vendosur sipas revizionit të paditurit, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.551/2022, të datës 28.08.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 27.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet i pa bazuar revizioni i të paditurit Aeroporti Ndërkombëtar “L. K.” sh.a në P., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.551/2022, të datës 28.08.2024.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, C.nr.779/20, të datës 20.12.2021, "Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses E. V. nga P., dhe detyrohet i padituri Aeroporti Ndërkombëtar “L. K.” sha, me seli në fshatin V., komuna e L., që paditëses ta kthejë në punë dhe detyra të punës si “Kontrollim të Peshave”, për kohë të pacaktuar dhe t’ia

shpërblejë paditëses dëmin material për shkak të mos realizimit të ardhurave personale për periudhën kohore prej datës 26.05.2017, e deri me datën 22.10.2021 dhe atë për paga neto në shumë prej 28,201.47.-€, me kamate prej 8 % në vit, duke filluar nga data 22.10.2021, e deri tek pagesa definitive. Ndërsa në emër të kontributit pensionale në llogarinë e paditëses në Trustit Pensional të Kosovës, t'ia paguaj shumën prej 1,583.03.-€ për punëdhënësin dhe 1,583.03.-€ për punëmarrësin. Në emër të tatimit në burim, shumën prej 1,876.10.-€, si dhe në emër të kamatës së arritshme, shumën prej 4,774.14.-€ si dhe t'ia kompensoi shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1968.-€, të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e dorëzimit të aktgjyqimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr.551/2022, të datës 28.08.2024 në afat ligjor ka paraqitur revizion i padituri, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta pranojë si të bazuar revizionin, ndërsa aktgjyqimet e gjykatave të instancave më të ulëta të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në revizion ka paraqit i autorizuari i paditëses avokat Ismet Musliu nga P. me propozim që të refuzohet revizioni si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 215 duke shqyrtuar ligjshmërinë e aktgjyqimit të goditur vetëm në pjesën lidhur me refuzimin e ankesës, gjeti se:

Revizioni i të paditurit Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "A. J.", "L. K.", është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja më datë 25.03.2015, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurit për shkak të anulimit të njoftimit të paditurës të datës 03.03.2015, dhe përgjigja në ankesë si të pa ligjshme, si dhe të obligohet e paditura që paditësen ta kthej në vendin e punës, në punët e detyrat e njëjta si dhe t'ia kompensoi të ardhurat personale.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë në seancën e shqyrtimit kryesor pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin

C.nr.104/15, të datës 18.09.2017, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses ashtu që është anuluar si i kundërligjshëm njoftimi i të paditurit Aeroporti Ndërkombëtar “L. K.” sha, me seli në fshatin V., Komuna e L., i datës 03.03.2015, dhe përgjigja në kërkesën e paditëses HR-..., e datës 19.03.2015, për mos përtëritjen e kontratës së punës, së datës 03.04.2015, dhe është detyruar i padituri ta kthej paditësen në punë dhe detyrat e punës në kohën e përcaktuar në vendin e mëparshëm, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës si dhe t’ia kompensoi të ardhurat personale për periudhën kontestuese siç është përshkruar në aktgjykimin në fjalë, këto në afat prej 7 dite nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin e sajë Ac.nr.7903/17, të datës 22.07.2020, e ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar ankesën e të paditurit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin C.nr.104/15, të datës 18.09.2017, në pikën I, të dispozitivit në të cilin është anuluar si i kundërligjshëm njoftimi i të paditurit i datës 03.03.2015, dhe përgjigja e paditëses dhe në pikën II të dispozitivit përkitazi me detyrimin e të paditurit për kompensimin e të ardhurave personale për periudhën kontestuese, kontributeve pensionale, tatimin në burim, me kamatë ligjore, dhe për pagesën e shpenzimeve të procedurës kontestimore, ndërsa e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e të paditurit, e ka prishur aktgjykimin e shkallës së parë në pikën II të dispozitivit përkitazi me vendimin për detyrimin e të padituit që paditësen ta kthej në vendin e mëparshëm të punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, ndërsa lënda për këtë pjesë është kthyer në shkallë të parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin e saj Rev.nr.503/20, të datës 27.01.2021, e ka refuzuar si të pabazuar revizionin e të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me numër Ac.nr.7903/17, të datës 22.07.2020, përkitazi me pjesët e refuzuara të ankesës së të paditurit.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.779/20, të datës 20.12.2021 me të cilin përsëri e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur më detajisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata ka theksuar se nuk ishte kontestues fakti se paditësja është larguar nga puna në mënyrë të kundërligjshme, pasi që ky fakt është vërtetuar me aktgjykimin e kësaj gjykate C.nr.104/15, të datës 18.09.2017, në pikën I të dispozitivit në të cilin

është anuluar si i kundërligjshëm njoftimi i të paditurit dhe në pikën II të dispozitivit sa i përket kompensimit të pagave të papaguara kontributeve pensionale tatimit në burim dhe shpenzimet e procedurës, I cili është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7903/17, të datës 22.07.2020. Kontestuse në mes të palëve ndërgjyqëse është fakti i kthimit të paditëses në vendin e mëparshëm të punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës dhe lënda është kthyer në riprocedurë nga Gjykata e Apelit, pikërisht për ta vërtetuar këtë fakt, andaj për ta vërtetuar faktin kontestues, gjykata ka bërë administrimin e provave plotësuese ku mbi bazën e këtyre provave të lartpërmendura e veçanërisht nga shkresa e të paditurit e datës 18.08.2021, të cilës i është bashkangjitur vërtetimi i datës 17.08.2021, dhe Organogrami i vendeve të punës tek i padituri, vërtetohet se ky vend i punës ku ka punuar paditësja E. V. “Agjente e kontrollit të peshave”, është aktive dhe është e strukturuar brenda Njësisë së kontrollit të peshave - Mbikqyrja e Aeroplanit. Gjykata e shkallës së parë vendimin si në dispozitiv të aktgjykimit e morri duke u bazuar në nenin 79 dhe 80 të Ligjit të Punës dhe nenit 136 të LMD/ Ligjin nr. 04/L-077.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare. Gjykata e Apelit e pranon në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, pasi që i njëjti vendim është në përputhje të plotë me provat materiale të administruara nga shkalla e parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e instancave më të ulëta edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme me referencë në dispozitat e cituara Ligjit të punës. Kjo për faktin se baza ligjore e kthimit në punë dhe e kompensimit të ardhurave ishte vërtetuar me aktgjykimin e plotfuqishëm dhe sipas udhëzimeve të gjykatës së shkallës së dytë, gjykata e shkallës së parë ka qenë e udhëzuar që të obligoi të paditurin që ta kthejë në vendin e punës, por jo në mënyrë të pa specifikuar siç ka qenë aktgjykimi i cili ishte prishur në këtë pjesë të kërkesëpadisë që ka të bëjë me atë që paditëses t’i njihen të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës. Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë se dispozitivi i aktgjykimit tani është i qartë dhe i zbatueshëm kur obligohet e paditura që paditësen ta kthejë në punë dhe detyra të punës si “Kontrollim të Peshave”, për kohë të pacaktuar dhe t’ia shpërblejë paditëses dëmin material për shkak të mos realizimit të ardhurave

personale për periudhën kohore prej datës 26.05.2017, e deri me datën 22.10.2021. Ky vendim është i drejtë edhe pasi që bazohet tek Organogrami i vendeve të punës tek e paditura, dhe nga i cili u vërtetua se ky vend i punës ku ka punuar paditësja E. V. “Agjente e kontrollit të peshave”, është aktive dhe është e strukturuar brenda Njesisë së kontrollit të peshave - Mbikëqyrja e Aeroplanit.

Po ashtu Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon vlerësimin e Gjykatës së Apelit se gjykata e shkallës së parë ka aplikuar drejtë të drejtën materiale në raport me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë çështje juridike kontestuese nga ku ka rrjedhur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe se i padituri duhet t'ia kompensoi të ardhurat personale për periudhën e caktuar kohore. Kjo pasi që largimi nga puna i paditëses vlerësohet si i paligjshëm (*pasi që për këtë tani ekziston aktgjykimi i formës së prerë në të gjitha instancat gjyqësore*), dhe për këtë arsye paditësit i takon e drejta për kthim në punë dhe në kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna, në shumën e vërtetuar nga ana e ekspertizës financiare të ekspertit financiar gjyqësor të datës 08.10.2021.

Duke u nisur nga fakti se revizioni paraqet pretendime lidhur me praktikën e gjykatave në lidhje me rastet e ngjashme të vendosura nga kjo gjykatë edhe pse çështja është vendosur me parë me aktgjykim të formës së prerë, Gjykata Supreme e Kosovës e gjene të nevojshme të sqaroi praktikën e saj lidhur me aplikimin e nenin 10 Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “ 1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuari. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji. 2. Kontrata e Punës mund të lidhet për: 2.1. një periudhë të pacaktuar; 2.2. një periudhë të caktuar; dhe 2.3. për punë dhe detyra specifike. 3. Kontrata e punës që nuk përmban kurrfarë hollësish për kohëzgjatjen e vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar. 4. Kontrata për periudhë të caktuar nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vite. 5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore. 6. Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindnjëzet (120) ditë brenda një (1) viti. 7. Personi që ka lidhur kontratë të punës për një afat të caktuar ose për një detyrë specifike, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parapara me këtë ligj, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj.

Për shkak se me aktgjykimin e atakuar si dhe atë të shkallës së parë, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, drejtë është aplikuar e drejta materiale dhe me pretendimet e revizionit nuk vihet në pyetje ligjshmëria e aktgjykimeve të atakuar, revizioni i të paditurit, u refuzua si i pa bazuar.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion, nuk janë vlerësuar, pasi që sipas dispozitës së nenit 214 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me nenin 222, dhe 224.1, të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.595/2024, datë 27.01.2025

Kryetari i kolegjit,

Beshir Islami